Procesverbal takimit Plani për mbrojtjen e Trashëgimisë kulturore në Deçan

Dt.22.02.2024

Takimi u mbajt në sallën e Asamblesë Komunale

Pjesëmarrës ishin 7 persona dhe vet anëtarët e këtij Komisioni 4 anëtarë.

Fjalën hyrëse kryetari i komisionit Bekim Vishaj, ai elaboroj rregulloren-planin për trashëgiminë kulturore dhe rëndësinë që ka ky plan për Deçanin.

Ai foli për: Rëndësinë e trashëgimisë kulturore si resurs për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, shoqëror dhe kulturor në nivel vendi është e madhe. Ndër të tjera tha, se "Komuna e Deçanit me trashëgiminë kulturore që ka dhe me potencialet e shumta të trashëgimisë natyrore ofron kushte dhe mundësi të mëdha zhvillimit të turizmit."

Po ashtu ai shpjegoj se, Qëllimet e këtij Plani janë në përputhje të plotë me politikat shtetërore të paraqitura përmes Strategjisë Kombëtare për Trashëgimi Kulturore 2017-2027, me theks te masat e parapara për arritjen e qasjes së integruar në trashëgimi, përfshirjen e trashëgimisë kulturore në planet zhvillimore (komunale), promovimin, shfrytëzimin e trashëgimisë kulturore si dhe mbrojtjen e saj.
Në pika të shkurtra shpjegoj përmbajtjen e këtij plani, siç vijon.

1. HYRJE

2. HISTORIKU I DEÇANIT

3. METODOLOGJIA E PUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT

4. OBJEKTIVAT E PLANIT

5. TRASHËGIMIA KULTURORE NË DEÇAN, (ANALIZA SWOT)

6. TRASHËGIMIA KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

7. LISTA ME OBJEKTET E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT, QË JANË NËN MBROJTJE TË PËRKOHSHME NGA MKRS

8. PRIORITETET SIPAS PLANIT

9. MASAT REKOMANDUESE SIPAS PLANIT1

10. MIRATIMI, REALIZIMI, ZBATIMI, MONITORIMI DHE VLERËSIMI I PLANIT

11. NDIKIMI FINANCIAR I PLANIT

12. GJENDJA FIZIKE E OBJEKTEVE KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

13. LISTA E AKTIVITETEVE KULTURORE TRADICIONLE NË FUSHËN E TRASHËGIMISË KULTURORE NË KOMUNËN E DEÇANIT

14. REZULTATET E PRITURA TË PLANIT

15. EKIPI I PUNËS GJATË HARTIMIT TË PLANIT

Afrim Hasanmetaj, UD i Shefit të DKRS, tha së në tërësi është i nevojshëm dhe të bëhet çmos që të jetësohet në praktikë ky plan.

Nga të pranishmit u përgëzua komisioni për punën e bërë, u tha të jetësohet ky plan në praktikë.

Procesmbajtës:

**Afrim Hasanmetaj**